REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar / Primljeno/Prosljeto / Recieved/Delivery 05 - 10 - 2018 viti god year			
Organ/Njësia / Organ/Jedinica / Org.Unit	Nr.Prot: / Br.Prot: / Prot.No:	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKDMSHCK	5800/2018		1/3

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.511/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Gjylinaze Gola dhe Lulzim Aliaj - anëtarë, Hysni Mustafa - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, për shqyrtimin e ankesës A.nr.511/2018, të datës 06.08.2018 të ankuesit Aziz Rexhepi, me adresë banimi Fshati "Komogllavë", nga Komuna e Ferizajt, kundër organit të punësimit Komuna e Ferizajt në çështjen juridike " Pezullim parandalues", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 04.10.2018, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.511/2018 të datës 06.08.2018, të parashtruar nga ankuesi Aziz Rexhepi.

A r s y e t i m

Ankuesi, Aziz Rexhepi, i punësuar në Komunën e Ferizajt, në pozitën "Drejtor i Shkollës se Mesme Ekonomike "Faik Konica", sipas Kontratës se punës 02.09.2013, me numër protokolli Nr. 04/399-12, me kohëzgjatje nga data 18.08.2013, deri me datën 17.08.2017. Kryetari i Komunës se Ferizajt, me datën 10.12.2015, me numër protokolli 319/15, ka nxjerr vendim me të cilin e ka pezulluar me 50% të pagës mujore prej datës 11.12.2015, për shkak se ndaj ankuesit Aziz Rexhepi, është duke u zhvilluar procedure penale në Prokurorinë Themelore në Ferizaj.

Ankuesi Aziz Rexhepi me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR.nr.78/16 i datës 13.12.2017 është liruar nga akuza si rezultat i se cilës është nxjerrë vendimi i Kryetarit të Komunës së Ferizajt për pezullim parandalues.

Prokuroria Themelore në Ferizaj ushtron ankesë kundër vendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR.nr.78/16.Gjykata e Apelit me datë 27.04.2018 nxjerr aktgjykimin me numër PAKR.nr.118/2018 me të cilin e vërteton Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj të datës 13.12.2017, me të cilin ankuesi Aziz Rexhepi shpallet i pafajshëm.

Drejtoria Komunale e Arsimit e Komunës së Ferizajt duke u mbështetur në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR.nr.118/2018 të datës 27.04.2018 dhe kërkesës së ankuesit me datë 13.07.2018 nxjerr Vendim me numër protokolli 1297 me të cilin i aprovohet kërkesa e ankuesit Aziz Rexhepi për kompensimin e pagës së parealizuar prej 50%, duke i refuzuar kërkesën për kthimin në vendin e punës.
Ankuesi kundër vendimit të Drejtorisë Komunale të Arsimit të Komunës së Ferizajt të datës 13.07.2018 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Komunën e Ferizaj. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Ferizaj me datë 25.07.2018 nxjerr njoftim për ankesën e ankuesit Aziz Rexhepi, me te cilin vlerëson se çështja rreth pretendimeve ankimore të ankuesit pas vendimit të Drejtorisë Komunale të Arsimit është e përmbyllur.

Ankuesi Aziz Rexhepi, i pakënaqur me njoftimin e datës 25.07.2018 , me numër protokolli 02-070/01-0077229/18 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Ferizajt, brenda afatit ligjor në pajtim me nenin 12 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, me datën 06.08.2018, ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 06.08.2018, e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankese të ankuesit në Komunën e Ferizajt, me datën 20.05.2018, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankese nga Komuna e Ferizajt, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.511/2018 me numër protokolli 4509/2018 të datës 06.08.2018 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 13.07.2018 me numër 1297; Vendimi për pezullim parandalues i datës 10.12.2015 me numër protokolli 01.nr.319/15; Njoftimi i datës 25.07.2018; Aktgjykimi PAKR.nr.118/2018 i datës 27.04.2018; Aktgjykimi i datës PKR.nr.78/16; Kontrata e punës e datës 02.09.2013 me numër protokolli 04/399-12; Formulari i regjistrimit te ankesës ne KPMSHCK; Kërkesa për përgjigje e datës 06.08.2018; Përgjigje në ankese e datës 20.08.2018, me numër protokolli 4784/2018, me shkresat e bashkangjitura 1/22; Formulari i ankesës në Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Komunën e Ferizajt e datës 19.07.2018 me numër protokolli 02-070/01-0077229/18; Ankesa në Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Komunën e Ferizajt e datës 19.07.2018; Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Ferizajt i datës 13.06.2018 me numër protokolli 1297; Njoftimi i datës 20.10.2015; Kontrata e Punës e ankuesit e për periudhën kohore 01.09.2010 deri më 31.08.2011; Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A.02/799/2017 i datës 25.01.2018 dhe Kartela e ankuesit Aziz Rexhepi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ekziston baza ligjore për përfundimin e procedimit lidhur me ankesën e ankuesit Aziz Rexhepi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar ankesën e ankuesit dhe të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke vendosur për ankesën e ankuesit me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike, me datë 25.01.2018 ka nxjerr Vendimin me numër A.02/799/2017, me të cilin e ka refuzuar si të

pabazuar ankesën e ankuesit Aziz Rexhepi lidhur me ndërprerjen e kompensimit 50% të pagës mujore për shkak te skadimit të afatit të kontratës së punës.

Duke marr parasysh dispozitat e nenit 101 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku është përcaktuar se: ***„Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike"***, si dhe faktin që Këshilli ka vendosur me Vendimin e datës 25.01.2018 për ankesën e ankuesit të datës 19.12.2017 me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka vendosur për përfundimin e procedurës lidhur me ankesën e ankuesit të datës 06.08.2018.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr.511/2018.

Malsore GASHI-BAJRAKTARI
Kryetare e Kolegjit

Hysni Mustafa
Procesmbajtës

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit Aziz Rexhepi;*
- *Kryetarit të Komunës së Ferizajt;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Ferizajt;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*